

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7845  
E premte, 26 korrik 2024  
Çmimi 0.50

A po kthehet statusi  
i Kosovës në tavolinën  
e bisedimeve?! | PAGE 4



Behxhet Sh. SHALA

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE



# VARFËRIA, PAPUNËSIA DHE ÇMIMET, PROBLEMET KRYESORE TË QYTETARËVE

FACE 4



KROACIA SHPALL PERSONA TË  
PADËSHIRUAR TRE POLITIKANË  
NGA MALI I ZI F. 2

IKSHPK-ja: KUJDES NGA PICKIMI I  
MUSHKONJAVE, RREZIK INFETIMI  
NGA VIRUSI I NILIT PERËNDIMOR F. 7

POLICIA ARRESTON NJË TË  
DYSHUAR PËR DHUNËN NDAJ  
TRUPAVE TË KFOR-IT NË ZVEÇAN F. 6

## EKONOMI



SHKALLA E PAPUNËSISË MË 2023  
ISHTE 10,9 %, MË E ULËT SESA NË  
VITIN 2022 F. 8

RRITET PËR 15 PËR QIND SKEMA  
PËR PENSIONET E FSK-së F. 8

## SPORT



KRASNIQI: NËNTË GARUESIT E  
KOSOVËS KANË POTENCIAL PËR  
MEDALJE NË LOJËRAT OLIMPIKE  
'PARIS 2024' F. 10

**DROJA  
E KOMUNAVE  
NË VERI:  
MË PAK BANORË,  
MË PAK BUXHET**

F. 5



**NË ZGJEDHJET E  
ARDHSHME VOTUESIT  
MUND TË ZGJEDHIN  
DERI NË 10 KANDIDATË  
PËR DEPUTETË F. 5**



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Franca kryen operacion të madh kundër spiunazhit kibernetik

PARIS, 25 KORRIK - Autoritetet në Francë kanë nisur një operacion të madh për t'i pastruar kompjuterët e infektuar nga një program i spiunazhit kibernetik që ka prekur miliona përdorues në mbarë botën. "Në prag të Olimpiadës, ky operacion tregon se lojtarë të ndryshëm në Francë dhe jashtë vendit janë të

mobilizuar që të luftojnë të gjitha format e krimit kibernetik", tha kryeprokurorja e Parisit, Laure Beccuau, përmes një deklarate më 25 korrik. Ajo tha se hetuesit po shënjestrojnë një rrjet të 'bot'-ëve, që dyshohet se ka infektuar kompjuterët me një virus. Po ky rrjet besohet se po vjedh të dhëna nga përdoruesit, "veçanërisht për

qëllime spiunazhi". Beccuau tha se analistët dhe hetuesit kanë arritur të marrin në kontroll serverin që ka në kontroll miliona kompjuterë të infektuar me virus. Autoritetet franceze e kanë nisur këtë operacion më 18 korrik dhe i njëjti pritet të zgjasë disa muaj. Sipas njoftimit, deri më tani

autoritetet kanë arritur të ndihmojnë viktimat në disa shtete evropiane. Në njoftimin e kryeprokurores së Parisit nuk u përmend ndonjë kërcënim specifik ndaj Lojërave Olimpikë që do të mbahen në Paris. Por, ndaras, agjencia për siguri kibernetike në Francë tha javën e kaluar se sulmet kibernetike do të



jenë "të pashmangshme" gjatë Olimpiadës, e cila nis të premten.

## ShBA-ja dhe Kanadaja detektojnë avionë të Ruisë dhe të Kinës afër Alaskës

WASHINGTON, 25 KORRIK - Avionët luftarakë të Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë u ngritën në ajër pasi dy avionë rusë dhe dy të ushtrisë kineze u detektuan në hapësirën ndërkombëtare afër Alaskës bëri me dije Komanda e Mbrojtjes së Hapësirës Ajrore të Amerikës së Veriut (NORAD). "NORAD detektoi, gjurmoi dhe pengoi dy avionë rusë TU-95 dhe dy avionë ushtarakë PRC H-6 duke operuar në Zonën e Identifikimit të Mbrojtjes Ajrore të Alaskës [ADIZ] më 24 korrik 2024. Avionët luftarakë të NORAD-it



nga ShBA-ja dhe Kanadaja kryen operacionin", u tha në deklaratë. "Zona e identifikimit" është një pjesë e hapësirës ajrore

ndërkombëtare që vepron si zonë ndalimi dhe zona gjendet aty ku përfundon hapësira ajrore kombëtare e ShBA-së dhe

Kanadasë. Të gjithë avionët që hyjnë në ADIZ duhet të identifikohen për arsye të sigurisë kombëtare, tha NORAD. Prania e avionëve rusë dhe kinezë nuk u pa si kërcënim, pasi që fluturaket qëndruan në hapësirën ajrore ndërkombëtare dhe nuk shkelën sovranitetin ajror të ShBA-së apo Kanadasë, tha NORAD, duke shtuar se do të "vazhdojmë ta monitorojmë aktivitetin e konkurrentëve afër Amerikës së Veriut dhe do t'i përgjigjemi pranisë së tyre". Rusia për një kohë të gjatë ka prani ushtarake në Paqësorin

Verior dhe pengimi i avionëve rusë është relativisht i zakonshëm në këtë zonë. Pengim i referohet kontaktit pamor apo elektronik të avionëve të huaj nga ata të NORAD-it. Ushtria e Pekinit vitet e fundit ka zgjeruar praninë e saj përtej Kinës, me anijet kineze që janë detektuar në ujërat afër Alaskës. Më herët gjatë këtij muaji, ShBA-ja detektoi katër anije të Kinës në Zonën Ekskluzive Ekonomike të ShBA-së, që është një zonë prej 370 kilometrash që shtrihet në det nga brigjet amerikane.

## Kroacia shpall persona të padëshiruar tre politikanë nga Mali i Zi

ZAGREB, 25 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane e Kroacisë ka njoftuar sot Malin e Zi përmes një note drejtuar Ambasadës së Malit të Zi në Zagreb, se Zagrebi ka shpallur kryetarin e parlamentit malazez, Andrija Mandiq, deputetin Millan Knezheviq dhe zëvendëskryeministrin Aleksa Beçiq, persona të padëshirueshëm. Mandiq dhe Knezheviq udhëheqin dy parti të ish-Frontit Demokratik prorus, ndërkaq Beçiq është udhëheqësi i demokratëve. Më herët gjatë kësaj jave, Fronti Demokratik u bë pjesë e Qeverisë të Malit të Zi, që udhëhiqet nga kryeministri Millojko Spajiq. Zagrebi tha se ky vendim u mor për shkak se këta politikanë kanë kryer veprime të vazhdueshme për prishjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe për shkak të, siç u tha, abuzimit të Kroacisë për qëllime të brendshme politike. "Ministria e Punëve të Jashtme shpreh keqardhjen që shumica në Parlamentin e Malit të Zi vendosi t'i shpërfillë thirrjet e vazhdueshme të Republikës së Kroacisë për të mos ndërmarrë lëvizje që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet tona dypalëshe dhe në rrugën evropiane të Malit të Zi. Në këtë kontekst, vihen në pah

veprimet e zyrtarëve politikë të përmendur, të cilët nuk mund të konsiderohen dashamirës dhe fqinjësorë në raport me Republikën e Kroacisë dhe as nuk janë në përputhje me qëllimin e deklaruar për anëtarësim të Malit të Zi në Bashkimin Evropian", u tha në njoftim. Sipas Ministrisë kroate, fqinjësia e mirë është një ndër elementët kyç të procesit të zgjerimit dhe atij të stabilizim-asociimit "dhe një nga kriteret kryesore për vlerësimin e përparimit në procesin e anëtarësimit të Malit të Zi" në Bashkimin Evropian. Kroacia tha se e mbështet anëtarësimin e Malit të Zi në BE. "Republika e Kroacisë pret që Mali i Zi të sillt në përputhje me vlerat evropiane dhe në frymën evropiane dhe t'i përqendrojë përpjekjet e tij për përmbushjen e mëtejshme të kushteve dhe kriterëve në procesin e anëtarësimit", u tha në njoftim. Zëvendëskryeministri malazez, Aleksa Beçiq, ka reaguar i pari. Ai ka vlerësuar se Kroacia e ka shpallur të padëshirueshëm për shkak se partia e tij ka votuar për Rezolutën për gjenocidin në Jasenovac. Siç shtoi ai, Kroacia nuk kishte të njëjtat kriterë për liderët e tjerë nga qeveria, partitë e të cilëve votuan për të njëjtën rezolutë. "Pra, padyshim që



nuk ka kriterë, ka politikë, si më parë në vendimet e disa fqinjëve të tjerë". Duke reaguar ndaj informacionit se ai ishte shpallur i padëshirueshëm, Milan Knezheviq, deklaroi në rrjetin X se gjyshi i tij e ka çliruar qytetin kroat Karlovac nga ustashtët dhe nazistët në vitin 1945. "Duket sikur ata fituan dhe ne humbëm", tha Knezheviq. Hyrja në ekzekutiv e Frontit Demokratik dhe të Partisë së Boshnjakëve nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Podgoricë u prit me shqetësim, pasi Uashingtoni vuri në pah se në ekzekutiv kanë hyrë parti që nuk e dënojnë agresionin rus kundër Ukrainës dhe janë kundër sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër Ruisë. Politika e Frontit Demokratik është në kundërshtim me politikën

zyrtare të Malit të Zi, i cili është kandidati më serioz për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ministria e Jashtme e Malit të Zi nuk ka komentuar ende për vendimin e autoriteteve kroate për tre politikanët e Malit të Zi. Reagime ende nuk ka as nga Mandiq, Beçiq dhe Knezheviq. Shpallja e tre politikanëve të padëshiruar vjen pasi, me iniciativën e Andrija Mandiqit dhe Milan Knezheviqit, më 28 qershor shumica parlamentare në Mal të Zi miratoi Rezolutën për gjenocidin në Jasenovac. Jasenovaci - 70 km në lindje të kryeqytetit të Kroacisë, Zagreb - është i njohur për vrasjet masive të hebrenjve, serbëve, romëve dhe kroatëve antifashistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vlerësimet e numrit të të varëve

atje ndryshojnë, por historianët e pavarur thonë se ai sillet midis 80 000 dhe 100 000. Qeveria kroate i konsideron ngjarjet atje si krim të Luftës së Dytë Botërore. Para miratimit të kësaj rezolute, Kroacia i dërgoi një notë proteste Malit të Zi. Përkundër kësaj, rezoluta u miratua në Kuvend me mbështetjen e një deputeti të Evropa Tani, të Millojko Spajiqit. Përveç partive të koalicionit prorus të Mandiqit dhe Knezheviqit, rezoluta u mbështet nga demokratët e Alekse Beçiqit dhe Partia Popullore Socialiste proserbe. Në ditën kur u miratua rezoluta në Mal të Zi, Kroacia tha se ky veprim nuk i kontribuon ndërtimit të një kulture të përkujtimit, por se është "instrumentalizim i viktimave të Jasenovacit" për qëllime të politikës ditore. Rezoluta për Jasenovacin ishte një përgjigje politike e forcave proserbe në Mal të Zi ndaj mbështetjes së qeverisë malazeze për rezolutën e Kombeve të Bashkuara për gjenocidin në Srebrenicë, e cila u miratua në fund të majit. Rezoluta për Srebrenicën u kundërshtua nga zyrtarët proserbë të Malit të Zi, përfshirë edhe nga kryetari i Parlamentit, Andrija Mandiq.

# Varfëria, papunësia dhe çmimet, problemet kryesore të qytetarëve



Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar edicionin e 26 të Përmbledhjes të Pulsit Publik. Të dhënat për këtë përmbledhje janë mbledhur nga 17 prilli deri më 7 maj 2024, duke reflektuar opinionin e mbi 1 300 të anketuarve që mbulojnë të tridhjetë e tetë komunitet, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale, po ashtu duke përfshirë të gjitha komunitetet e Kosovës. Varfëria (16.6%), papunësia (16.3%) dhe çmimet për furnizimet thelbësore (12.7%) u regjistruan si tre çështjet kryesore. Shërbimet e kujdesit shëndetësor (7.8%) dhe mjedisi (5.6%) plotësuan pesë problemet kryesore

kryesore. Shërbimet e kujdesit shëndetësor (7.8%) dhe mjedisi (5.6%) plotësuan pesë problemet kryesore. Për shqiptarët e Kosovës tri çështjet kryesore ishin papunësia (16.8%), varfëria (16.6%) dhe çmimet për furnizimet esenciale (12.8%). Për serbët e Kosovës, varfëria (15.2%), problemet e hapësirës urbane (13.8%) dhe marrëdhëniet ndëretnike (13.3%) ishin tri çështjet kryesore, ndërsa për komunitetet e tjera të Kosovës, çështjet kryesore ishin varfëria (19.5%), furnizimi me energji elektrike (14.2%) dhe problemet e hapësirës urbane (11.1%). Një total prej 83.2% përqindësh e të anketuarve raportuan se ndihen të sigurt nga dhuna dhe krimi kur janë në rrugë. Të dhënat e ndara sipas gjinisë treguan se 83.4% e burrave dhe 82.9% e grave ndihen të sigurt kur janë në rrugë. Të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike treguan se

një numër më i madh i shqiptarëve të Kosovës (85.3%) dhe komuniteteve të tjera të Kosovës (83.2%) krahasuar me serbët e Kosovës (31.9%) ndiheshin të sigurt kur ishin jashtë në rrugë. 60% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat fitohet në bazë të meritës, krahasuar me punësimin në sektorin publik, për të cilin vetëm 32% e të anketuarve kanë pohuar të njëjtën gjë. Një rritje si në Indeksin e Demokratizimit (ID-ja) ashtu edhe në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE-ja) u regjistrua në anketën e fundit të opinionit me ID që aktualisht qëndron në 1.62 dhe IBE në 1.21. 27.3% e të anketuarve janë deklaruar se janë shumë të kënaqur apo të kënaqur me drejtimin ekonomik, ndërsa 36.33% e të anketuarve janë deklaruar se janë shumë të kënaqur apo të kënaqur me drejtimin politik drejt të cilit po shkon Kosova

aktualisht. Mesatarisht, 19.9% e të anketuarve kanë perceptuar se ekziston korrupsioni në shkallë të gjerë. Policia e Kosovës me 12.40% është perceptuar si institucioni më pak i korruptuar, e ndjekur nga organizatat ndërkombëtare me 13.70%. Për 65.3% të të anketuarve, informacioni nëpërmjet medias është ai që ka formësuar perceptimin e tyre për korrupsionin në shkallë të gjerë. 26.8% e të anketuarve kanë pohuar se biseda me të afërmit është ajo që ka formësuar perceptimin e tyre, ndërsa 6.3% e të anketuarve kanë pohuar se përvojat personale kanë formësuar perceptimin e tyre. Të dhënat e ndara etnikisht treguan se gjithsej 81% e komuniteteve të tjera të Kosovës, 76% e shqiptarëve të Kosovës dhe 54% e serbëve të Kosovës kishin gjasa të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Gjithsej 10.9% e të anketuarve besojnë plotësisht dhe 40.9% e tyre besojnë se marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit do të ndikojë pozitivisht në jetën e njerëzve. Të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike treguan se 52.9% e shqiptarëve të Kosovës dhe 51.6% e komuniteteve të tjera të Kosovës kishin një pikëpamje pozitive për marrëveshjen, krahasuar me 25.7% të serbëve të Kosovës.

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 KORRIK - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar edicionin e 26 të Përmbledhjes të Pulsit Publik në një konferencë për medie të mbajtur të enjten. Anketimi i opinionit të Pulsit Publik nxjerr në pah perceptimet e njerëzve për çështjet socio-ekonomike, politike dhe të sigurisë. Të dhënat për këtë përmbledhje janë mbledhur nga 17 prilli deri më 7 maj 2024, duke reflektuar opinionin e mbi 1 300 të anketuarve që mbulojnë të tridhjetë e tetë komunitet, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale, po ashtu duke përfshirë të gjitha komunitetet e Kosovës.

Disa nga gjetjet kryesore të anketës përfshijnë: Të dhënat tregojnë se mesatarisht 50.1% e njerëzve janë të kënaqur me punën e institucioneve kryesore qendrore të Kosovës. Kënaqshmëria me punën e kabinetit ekzekutiv u regjistrua 53.3%, ndërsa me punën e kryeministrit 58.3%. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit ishte 52.10%, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit ishte 64.4%. Kënaqshmëria me presidenten është regjistruar 69%. Shkalla e kënaqshmërisë me gjykatat ishte 27.1% dhe me Prokurorinë 26.5%. Varfëria (16.6%), papunësia (16.3%) dhe çmimet për furnizimet thelbësore (12.7%) u regjistruan si tre çështjet

## Pulsi Publik i UNDP-së: Kënaqshmëria me punën e presidentes 69 për qind, me të kryeministrit 58.3 për qind

Sipas anketimit të opinionit të Pulsit Publik, kënaqshmëria me punën e kabinetit ekzekutiv u regjistrua 53.3%, ndërsa me punën e kryeministrit 58.3%. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit ishte 52.10%, ndërsa kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit 64.4%. Kënaqshmëria me presidenten është regjistruar 69%.



# Droja e komunave në veri: Më pak banorë, më pak buxhet

PRISHTINË, 25 KORRIK - Për shkak të numrit të vogël të popullsisë së regjistruar, komunat e banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan - mund të marrin buxhet vjetor shumë më të vogël se më parë. Këtë shqetësim, së paku, shprehin zyrtarët komunalë në Mitrovicë të Veriut dhe në Zubin Potok. “Sigurisht që numri i banorëve do të reflektojë te buxheti. [Nga niveli qendror] do të na thonë: ju, komunarët, gjenduni për projekte dhe vendbanime, nëse mendoni se keni diçka”, thotë për Radion Evropa e Lirë, Katarina Axhançiq, nënkryetare e komunës së Mitrovicës së Veriut.

Numri i popullsisë në komuna është faktor në përcaktimin e buxhetit të tyre nga Qeveria e Kosovës.

Serbët e katër komunave në veri, kryesisht, e bojkotuan regjistrimin e popullsisë - që u bë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në pranverë - me kërkesë të Listës Serbe, e cila kundërshton autoritetin e institucioneve të Kosovës.

Sipas të dhënave paraprake të ASK-së, të publikuara më 12 korrik, vetëm rreth 6 500 njerëz në këtë zonë iu përgjigjën regjistrimit, ndërsa atje besohet se jetojnë dhjetëra mijëra.

## Pasoja të gjera

“Ky bojkotim i regjistrimit [nga serbët lokalë] mund të ketë pasoja edhe në ndarjen e buxhetit, por edhe në zhvillimin ekonomik”, thotë kryetari i Komunës së Zubin Potokut, Izmir Zeqiri, për Radion Evropa e Lirë.

Në këtë komunë, sipas të dhënave paraprake të ASK-së, janë regjistruar 758 banorë. Shifra është shumë më e ulët sesa vlerësimi i fundit i popullsisë në Kosovë, i bërë nga ASK-ja në vitin 2022. Sipas atij vlerësimi, në Zubin Potok jetojnë 6 628 banorë.

Dallime të mëdha vërehen edhe në tri komunat e tjera në veri.

Në Mitrovicë të Veriut, sipas të dhënave të deritashme të ASK-së, janë regjistruar 2 346 banorë, ndërsa sipas vlerësimit të vitit 2022, atje jetojnë 11 912 banorë. Në Leposaviq janë regjistruar 3 204 banorë, ndërsa kanë qenë 12 883, dhe në Zvečan janë regjistruar 435, ndërsa kanë qenë 7.165.

Katër komunat në veri e kanë bojkotuar kryesisht edhe regjistrimin e parafundit, më 2011, ndërsa buxhetet për to janë ndarë në bazë të vlerësimit të popullsisë.

Zyrtarët komunalë në Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok shpresojnë se institucionet

qendrore do ta kenë parasysh që numri i qytetarëve të regjistruar në komunat veriore, nuk paraqet numrin real të popullsisë atje. Për vitin 2024, Mitrovica e Veriut ka pasur buxhet prej rreth 6.3 milionë eurosh.

Nënkryetarja e komunës, Axhançiq, shpreson që buxheti komunal për vitin e ardhshëm të jetë së paku i njëjtë me këtë të këtij viti. “E lus Zotin për këtë, që të na e lënë aq”, thotë Axhançiq. “Duhet të gjendet një zgjidhje. Tani nuk e di... Me siguri që Qeveria [e Kosovës] do ta ketë parasysh se çfarë zgjidhjeje mund të bëhet”, thotë Zeqiri. Buxheti i sivjetmë i komunës që ai drejton është rreth 3.4 milionë euro.

Lidhur me këto shqetësime, Radio Evropa e Lirë iu drejtua Qeverisë së Kosovës, por zyrtarë të saj nuk ishin të gatshëm të saktësojnë se si do të gjendet zgjidhja.

Sipas tyre, “duhet pritur dhe analizuar shifrat dhe më pas të vendoset për buxhetet komunale”.

Rreth gjysma e buxhetit vjetor të komunave varet nga grantet e përgjithshme, të cilat i ndan Qeveria e Kosovës nga buxheti i përgjithshëm i vendit, e që sivjet ishte rreth 3.3 miliardë euro.

Rreth 90% e shumës së granteve të përgjithshme për komunat ndahen duke u bazuar në

numrin e popullsisë së komunës përkatëse.

Bekim Salihu, nga Instituti Kosovar për Studime të Avancuara - GAP, thotë për Radion Evropa e Lirë se mospjesëmarrja e qytetarëve në procesin e regjistrimit në veri, do të prodhojë efekte negative për vetë ata. “Më pak banorë nënkupton më pak buxhet. Ky është efekti i parë, por jo i vetmi, sepse edhe numri i asamblistëve nëpër kuvendet komunale përcaktohet nisur nga numri i popullsisë”, thotë Salihu.

Sipas tij, kur një komunë nuk di numrin e popullsisë dhe shtrirjen e saj, e as nivelin e arsimimit, profesionet e qytetarëve dhe çështje të tjera demografike, ajo e ka problem të hartojë edhe studime dhe plane të qëndrueshme.

Boban Simiq, nga Qendra për Veprime Afirmative Sociale - CASA në Kosovë, pajtohet se pjesëmarrja e ulët në regjistrimin në komunat në veri, nuk i godet vetëm institucionet komunale, por edhe vetë qytetarët.

“Kur të hyrat e komunës janë më të vogla, një gjë e tillë bën që shërbimet komunale dhe investimet kapitale të jenë më të pakta. Me këtë fakt, popullsia në përgjithësi ka mundësi më të pakta për zhvillim”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

## Vlerësimi i përgjithshëm i popullsisë si qasje alternative

Në rastet kur pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e regjistrimit është e ulët në komuna të caktuara, ekzistojnë mënyra për të përcaktuar numrin e përafërt, vlerësojnë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Drejtori i kësaj agjencie, Avni Kastrati, përmend vlerësimin e popullsisë, që, sipas tij, është standard ndërkombehtar.

Ai thotë se ASK-ja ka burime të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të popullsisë në komunat veriore të vendit. “Burimet janë administrative, prej anketave. Ne e kemi bërë një mini-regjistrim më parë dhe e kemi numrin e banesave, të shtëpive, sa janë të banueshme dhe sa të pabanueshme...”, thotë Kastrati për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se puna për vlerësimin e përgjithshëm të popullsisë në komunat e veriut të vendit nuk ka nisur, por se ekipet e punës janë të gatshme.

Deri në fund të vitit, ASK-ja do të mund të dalë me rezultatet e këtij vlerësimi, që, sipas Kastratit, do të jetë mbi 90 përqind i përafërt me numrin real të popullsisë së atjeshme.

## Liqeni i Ujmanit, Elshani: Zona konsiderohet të jetë e sigurt, ka patrullim të rregullt të policisë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Liqeni artificial i Ujmanit si një vend atraktiv është duke u shfrytëzuar nga shumë qytetarë për relaksim në këto ditë të nxehta të verës. Por, të dielën që lamë pas ndodhi një shpërthim pikërisht afër zonës së liqenit. Fatmirësisht, nuk pati të lënduar dhe u dëmtuan vetëm tri vetura.

Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës së Veriut, Veton Elshani, në një intervistë për "Telegrafi"-n ka folur rreth këtij rasti dhe hetimet që janë

duke u zhvilluar për këtë rast. Ai tha se zona konsiderohet e sigurt dhe ka shtim të patrullimit nga policia. Elshani tutje njoftoi se policia është duke hetuar rastin me qëllim të ndriçimit të të gjitha rrethanave. "Po të dielën, rreth orës 14:30, ka pasur një shpërthim që ende nuk është përkufizuar se çka e ka shkaktuar atë. Sidoqoftë, të lënduar në njerëz nuk kemi pasur dhe tri vetura kanë qenë të dëmtuara në atë rast. Ne kemi frekuentim të njerëzve, sidomos ditët e vikendit në atë

zonë. Zona konsiderohet të jetë e sigurt për momentin, sepse kemi edhe forca të shtuara policore në atë zonë. Sidoqoftë, 100 për qind nuk ka siguri. Por, konsiderojmë se do të shohim numër më të madh të njerëzve që e frekuentojnë atë zonë. Policët janë aty për çdo eventualitet. Policia ka filluar hetimin lidhur me rastin e fjalë. Kemi pasur disa bastisje, të cilat janë zhvilluar lidhur me rastin. Nuk kemi për momentin të dyshimtë, nuk kemi persona të arrestuar, mirëpo jemi duke punuar për

ndriçim të rastit", ka thënë Elshani.

Ai tha se komplet zonën e Ujmanit janë duke e menaxhuar. "E jona është me tregu që ka shtim të numrit të patrullave policore, ka policë të cilët edhe shihen edhe nuk shihen. Menaxhimi i vendit dhe i komplet zonës së Ujmanit bëhet në forma policore, që do të thotë jemi duke e kontrolluar atë zonë. Përsëri them nuk është 100 për qind e sigurt asgjë, as në këtë moment kur ne flasim këtu, nuk kemi siguri 100 për

qind. Sidoqoftë, policia është me numër të madh në atë zonë dhe konsiderojmë që zona mund të konsiderohet e sigurt", tha ai.

Më tutje Elshani tregoi se ditën që ndodhi shpërthimi rreth orës 21:00 kanë kryer një bastisje. "Çka mund të themi është se atë ditë kemi pasur një bastisje në orën 21:00, ndërsa hetimet e tjera, po mendoj veprimet e tjera policore, janë në kuadër të hetimeve dhe nuk mund të zbardhim më shumë", tha Elshani.



## Në zgjedhjet e ardhshme votuesit mund të zgjedhin deri në 10 kandidatë për deputetë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar një video përmes së cilës sqaron se me Ligjin e ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, në zgjedhjet e ardhshme votuesit mund të zgjedhin deri në 10 kandidatë për deputetë të Kuvendit nga i njëjti subjekt.

KQZ-ja në "Facebook" thekson se votuesi duhet të

zgjedhë vetëm një subjekt politik, ndërsa deri në 10 kandidatë për deputetë nga ai subjekt. "Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, në zgjedhjet e radhës për Kuvendin e Kosovës, sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, votuesi ka të drejtë të zgjedhë deri në 10 kandidatë për deputetë të një subjekti politik. Mënyra e

votimit është kjo: Së pari, në anën e majtë të fletëvotimit, votuesi duhet të zgjedhë vetëm një subjekt politik dhe, së dyti, në anën e djathtë të fletëvotimit, votuesi mund të zgjedhë deri në 10 kandidatë për deputetë të atij subjekti politik. Pra, voto vetëm një subjekt politik dhe deri në 10 kandidatë për deputetë", ka njoftuar KQZ-ja.



### A është, në fakt, real vlerësimi?

Që prej regjistrimit të parafundit të popullsisë në vitin 2011, ASK-ja ka publikuar vazhdimisht raporte vjetore të vlerësimit të popullsisë.

Çdo vit, ajo ka vlerësuar se popullsia është më e madhe sesa që është regjistruar më 2011, duke u bazuar në shifrat e natalitetit, mortalitetit dhe

migrimit.

Por, nga të dhënat paraprake të ASK-së del se popullsia në vitin 2024 është ndjeshëm më e vogël sesa në vitin 2011, përkatësisht 1.58 milion banorë, krahasuar me rreth 1.7 milion.

Edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare kanë pikëpamje të ndryshme nëse vlerësimi i përgjithshëm mund t'i afrohet numrit real të popullsisë së komunave përkatëse.

Salihu, nga Instituti GAP, thotë se kjo metodë e ASK-së nuk ofron rezultat të saktë.

Vlerësimi i popullsisë, sipas tij, bazohet në një regjistrim bazë, i cili pasohet me të dhënat nga numri i vdekjeve, numri i lindjeve dhe numri i migrameve. Ai thotë se për të gjitha këto, ASK-ja nuk i ka të dhënat e plota. "E para, regjistrimi [i parafundit] i vitit 2011 nuk ka qenë i plotë, as atëherë. Mangësia e dytë është që këto komuna [në veri] nuk

kanë raportuar në formë të rregullt dhe të plotë lidhur me lindjet dhe vdekjet. Ato nuk kanë as të dhëna për sa i përket migrimit", thekson Salihu. Por, Simiq nga organizata CASA beson se ekzistojnë disa tregues që vlerësimi i përgjithshëm i popullsisë në komunat në veri, t'i afrohet numrit real të popullsisë së atjeshme. Sipas tij, ASK-ja mund t'i referohet numrit të nxënësve të saporegjistruar në shkolla në

katër komunat e veriut, ndërsa në bazë të njësorëve që përlogaritin shpenzimet e energjisë elektrike, t'i evidentojë edhe amvisëritë.

Sidoqoftë, për të dhënat përfundimtare të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, që u zhvillua nga 5 prilli deri më 24 maj, do të duhet të pritët deri në fund të vitit, sipas ASK-së. Përafërsisht në atë periudhë miratohet edhe buxheti për vitin pasues.

## Mbahet dëgjimi i katërt publik në Mitrovicë me gra për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025

MITROVICË, 25 KORRIK - Në vazhdim të dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025, komuna e Mitrovicës vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe kontributit të grave në draftimin e buxhetit. Fillimisht, fjalën e mori zyrtarja për barazi gjinore, Besa Veseli, e cila falënderoi të gjitha gratë pjesëmarrëse duke i inkurajuar për dhënie

të propozimeve dhe komenteve. Për buxhetin në përgjithësi dhe për mënyrën e krijimit dhe shpërndarjes së tij foli zyrtari kryesor financiar Zenel Çitaku, i cili shpali buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin 2025-2027, duke bërë me dije se buxheti i komunës së Mitrovicës për vitin 2025 pritet të jetë 30 240 514.00

euro. "Paga dhe mëditje 16 981 995.00 euro, mallra dhe shërbime 4 820 000.00 euro, shpenzime komunale 600 000.00 euro, subvencione dhe transfere 1 209 150.00 euro, investime kapitale 6 629 369.00 euro", ka theksuar Çitaku. Me këtë takim kanë përfunduar edhe dëgjimet buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027.



## Policia arreston një të dyshuar për dhunën ndaj trupave të KFOR-it në Zveçan

ZVEÇAN, 25 KORRIK - Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka arrestuar të dyshuarin me iniciale D. D. në rajonin e Mitrovicës së Jugut lidhur me sulmin ndaj pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, në maj të vitit të kaluar në Zveçan.

Policia e Kosovës në veri ka konfirmuar se bëhet fjalë për arrestimin e Dushan Drobacit. Dhuna në Zveçan pati shpërthyer, pasi serbët lokalë patën kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, komuna në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

Si pasojë e dhunës patën mbetur të plagosur 93 pjesëtarë të KFOR-it, disa prej tyre rëndë.

Përmes një komunikate për medie, policia ka thënë se D. D. - ndaj të cilit është ngritur kallëzim penal në Prokurorinë Speciale - ka përdorur dhunë në mënyrë aktive në Zveçan

dhe është i dyshuar për katër vepra penale: bashkim për veprimtari kundërkushtetuese, rrezikim të personave nën mbrojtje ndërkombëtare, pjesëmarrje në turmë që kreu veprë penale dhe huliganizëm dhe sulm ndaj personit zyrtar.

Në përvjetorin e sulmit ndaj KFOR-it, më 29 maj, ky mision ka kërkuar që të mbahen përgjegjës të përfshirët në sulmin e vitit të kaluar. Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet në Zveçan, duke thënë se ato janë kryer nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq". Por, Serbia e ka mohuar një akuzë të tillë, duke akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se synonte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n".

Në Kosovë deri më tani janë arrestuar dhjetë persona për dhunë në protesta dhe për sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it. Aktualisht në Kosovë janë 4 700



pjesëtarë të KFOR-it. KFOR-i është përgjegjësi i tretë për

sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit

Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

## Arrestohet Metaj, i arratisuri nga burgu i Dubravës

**UJKAN (Rexhep) METAJ**

**KATEGORIA E VEPRËS:**

- Arratisja e personit të privuar nga liria

**PËRSHKRIMI:**

ADRESA: Shushicë e ulët-Istog  
MOSHA: 35 VJEÇ



PRISHTINË, 25 KORRIK - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar Ujkan Metajn, i cili është arratisur ditë më parë nga burgu i Dubravës. Policia ka thënë se veprimet e mëtejme do të ndërmerren në bashkëpunim me organet e drejtësisë.

Ujkan Metaj, lindur më 1988, është dënuar me 11 vjet burgim për ndihmë në grabitjen e një banke në Istog. Para se të arratiset, ai e ka fituar të drejtën e kalimit të fundjavës në shtëpi dhe ka qenë i vendosur në institucion të tipit të hapur.

Përveç Metajt, ditët e fundit nga burgu ishte arratisur edhe Faton Hajrizi. Autoritetet në Serbi kanë thënë se

e kanë vlarë Hajrizin javën e kaluar, meqë ai ka qenë në kërkim për vrasjen e një zyrtari policor dhe plagosjen e një tjetri në Lloznicë, qytezë serbe në afërsi të Bosnjë-Hercegovinës.

Autoritetet në Kosovë kanë bërë thirrje për hetim ndërkombëtar për rastin e Hajrizit dhe zhvillimet rreth tij në Serbi.

Më herët gjatë këtij muaji, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), Ismail Dibrani, ka thënë se nga viti 2007 e deri më tani nga burgjet e Kosovës janë arratisur - ose nuk janë kthyer pasi kanë shfrytëzuar të drejtën e kalimit të fundjavës jashtë burgut - 56 persona.

## Në Rahovec mbahet punëtorja për mbrojtje nga dhuna në familje

RAHOVEC, 25 KORRIK - I kryesuar nga zyrtari për barazi gjinore, Alban Gashi, njëherësh kryesues i grupit punues dhe i shoqëruar nga kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, është mbajtur punëtorja për harmonizimin dhe miratimin e Planit të Veprimit të Mekanizmit

Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Përgjatë punëtorisë u shqyrtuan të gjitha pikat e këtij plani, duke i bashkërenduar dhe harmonizuar të gjitha aktivitetit. Në fund të kësaj punëtorie anëtarët e Mekanizmit Koordinues

Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje miratuan planin njëzëri. Mekanizmi ka për qëllim t'i adresojë dhe t'i trajtojë çështjet e dhunës në familje, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve të ndryshme lokale dhe organizatave joqeveritare.



## A po kthehet statusi i Kosovës në tavolinën e bisedimeve?!



**EPOKA ERE** Behxhet Sh. SHALA

**Mësues të dobët, nxënësi ngelcan:** Albin Kurti që urbi et orbi ka dëshirë të thotë se është KM i Kosovës e pranoi Marrëveshjen e Brukselit, me aneksin e Ohrit që strategjikisht e shkatërron Kosovën si shtet, qoftë edhe si ide. Jam i bindur që po t'i kishte dëgjuar Dimal Bashën dhe Halil Thaçin, që konsiderohen si truri i njohjes së proceseve ndërkombëtare, pa të cilët nuk merret asnjë vendim i përmasave gjeostrategjike, Albini kurrë nuk do ta pranonte këtë marrëveshje. Thashë më lart se Dilmali dhe Lili janë nëna e mendimit politik global prandaj, kush nuk e dëgjon nënën, e dëgjon njerikën. Në vend të tyre, Albini u përcaktua të mbështet në mendimet e dy mercenarëve ndërkombëtarë: Mark Welleri dhe Jeton Qurroi. Këta e bindën se kjo Marrëveshje është e mirë dhe se: "njëherë të vjen vera kah dera...". Mark Wellerin, përveç se e paguan, "me lira" për këshillat e dëmshme për Kosovën dhe të dobishme për Serbinë, si bonus ia punësoi gruan si "ambasadore" të Kosovës në Greqi pasi Greqia ta njohë Kosovën (kur të bën shelnja rrush). Ndërkaq, mercenarin tjetër, Jeton Qurroin, si projugosllav dhe proserb të pjekur dhe të thekur gjithashtu e shpërbleu me tripletë; duke e

paguar si këshilltar, duke ia siguruar nga grazhdi i Naim Rashitit 3500 euro në muaj si këshilltar i Besnik Rrencit dhe, e treta duke ia bërë vajzën "miss" të kabinetit qeveritar. Jam i sigurt se Kurti po i ndjenë pasojat e nguljes në kunxhin e Brukselit dhe Ohrit prandaj, kinse po e kundërshton duke kërkuar që ajo të nënshkruhet edhe nga Vuçiq e që sipas njohësve nuk ka fare nevojë të nënshkruhet, veprimi oral apo gojor është obligativ për të dyja palët. Kurti, sa më shumë që po bënë zhurmë, më thellë po ngulet. Ngulitja e parë ishte refuzimi i pranimit në Këshillin e Evropës pas së cilës një analfabete jofunksionale që vetëm në Kosovë mund të bëhej ministre, i bënte karshillëk deputetëve evropianë duke iu thënë se Kosova më nuk ka asnjë detyrim ndaj tyre. Deklaratë e padenjë edhe për idiotin më të pazhvilluar!!! Pastaj, si rrence dhe mashtruese patologjike deklaronte se po punohet që Këshilli i Evropës të mbajë një mbledhje të jashtëzakonshme për ta pranuar Kosovën si anëtare. Me këto përgjigje nuk do ta merrte as një pesëshe (në fakultet) as te Ferid Agani apo Jysuf Ulaj ndonëse këta të dy kanë mandat për shëndetin mendor të kësaj partie për aq kohë sa janë në parti. Së fundi, qytetarëve serbë që kanë pasaporta të Zyrës Koordinuese

për Kosovë dhe Metohi, Evropa iu ka njohtë liberalizimin e vizave duke e dhunuar brutalisht integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës përmes ndarjes së sovranitetit midis Kosovës dhe Serbisë. Pas kësaj ma gjeni një njeri normal që beson se Kosova pashmangshëm dhe përfundimisht është ndarë nga Serbia?! Ndërkombëtarët asnjëherë dhe me asgjë nuk e kanë kushtëzuar Serbinë me njohjen e Kosovës por thonë se do të ishte e mirë, e pritshme dhe e logjikshme që në fund të procesit të ketë njohje reciproke. Marrëveshja e Brukselit dhe bishti - aneksi i Ohrit përfundimisht e liron Serbinë nga çdo detyrim që ta njohë Kosovën. Njohja e liberalizimit të viza për serbët e Zajebnicës nga BE, tregon se statusi i Kosovës nuk është zgjidhur përfundimisht dhe se të gjitha propozimet janë mbi tavolinën e bisedimeve, nga përkufizimi - ndarja territoriale e deri te ruajtja e status - quos. Po një gjë për mua është shumë e qartë, ndërkombëtarët me çdo kusht duan që ta lënë një kërthizë lidhëse të pandashme midis Kosovës dhe Serbisë prandaj edhe po sillen në këtë mënyrë. Kosova nuk ka litium që do ta kushtëzonte bashkësinë ndërkombëtare ndërkaq budallenjtë që po ua ofrojnë si open mind nuk po na i pranojnë

si pasuri natyrore e lëre më Intelktuale. Të tillë kemi sa të duanë. Ndërkaq, Albin Kurti me Çetën e Profetëve Budallenj nuk ka kapacitet të parandalojë këtë, madje duket se as që ka interesim përveç se ta mbajë pushtetin. Opozitë realisht nuk ka në Kosovë, po të mos ishte opozitarizmi kushtetues, kryesisht i PDK-së Kosova do të shndërrohej në Kamboxhë të Kmerëve të Kuq apo në Kore të Veriut. Qeveria aktuale po silllet si sandinistët kur e morën pushtetin në Nikuaragua, me politika sociale të rrejshme, vet u shndërruan në aristokratë. Asgjë nuk kanë bërë ata para këtyre, çka janë duke bërë këta sot. Albin Kurti, po të donte të dilte nga proceset gurthyese që i ka ngritur vet, nuk do ta shpërfillte, deri në poshtërim opozitën. Nuk do t'i dhunonte mediat që kanë qëndrim kritik ndaj tij. Nuk do t'i përndiqte shokët e Bacës Adem Demaçi. Nuk do të azilonte bijtë dhe bijat e udbashëve, hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve të Jugosllavisë dhe Serbisë. Nuk do t'ua shkurtoje përkrahjen financiare pengjeve të Hagës, më meritoret për lirinë e Kosovës dhe Kosovën shtet. Ma gjeni sot dikën në qeverinë Kurti, dikën që ka qenë pjesë e luftës përveç disa dezertorëve të ndyrë dhe hajdutë. Apo në mesin e deputetëve?! Turp është për Albinin që në strukturat që ai 100

përqind i kontrollon të ketë dëshmitarë të mbrojtur. Albin Kurti e kishte mundësinë të bëhej si Hasan Prishtina por këtij edhe emrin ia hoqi nga Universiteti i Prishtinës. Tash, Albini i duhet një spirancë për ankorim edhe për një mandat. Mundësisht para zgjedhjeve në ShBA, për t'u mos përballur me Trumpin, si fitues shumë i mundshëm. Trampit as që ia ndien leshi për Albinin, e as për të tjerët. Një gjë është e sigurt; sa më shumë të blejë kohë, humbësi më i madh do të jetë Albini. Dhe Kosova. Prandaj Albini duhet t'i kthehet mendjes duke kërkuar mbështetje nga ata që çdo gjë dhanë për lirinë e Kosovës. Duke u larguar nga ata që asgjë nuk dhanë për Kosovën dhe shqiptarët përveç se morën pamëritueshëm çdo gjë. Duke larguar nga qeveria ministra dhe ministere që vendin e kanë në psikiatri dhe jo në qeveri. Duke eliminuar urrejtjen dhe hakmarrjen si mjet për të ardhur në pushtet dhe për ta mbajtur pushtetin. Të premtën është përvjetori i kalimit në amshim të të Pavdekshmit, Bacë Adem Demaçit. Ne që kemi qenë gjithmonë afër Bacës Adem do të jemi aty. Sigurisht edhe Albini, me ndërgjegje të vrarë apo me maskën e përkohshme si nxënës politik i Bacës Adem. Është zgjidhja e tij. Nëse dikush ende i beson.

## IKShPK-ja: Kujdes nga pickimi i mushkonjave, rrezik infektimi nga Virusi i Nilit Perëndimor

**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka paralajmëruar qytetarët që të kenë kujdes nga pickimi i mushkonjave në verë për shkak të një sëmundjeje që mund të transmetojnë. "Virusi i Nilit Perëndimor, i cili është sëmundje sezonale e muajve të

verës, ka bërë që ekspertë të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës ta shtojnë gatishmërinë në parandalimin e shfaqjes së sëmundjes. Në Kosovë nuk ka raste të raportuara të Nilit Perëndimor, por duke pasur parasysh se raste të këtij virusi

janë regjistruar në disa vende të Evropës si në Spanjë, Itali, Greqi dhe në rajon gjithashtu, IKShPK-ja bën thirrje për kujdes të qytetarëve dhe parandalim të infeksionit që te njerëzit kryesisht është rezultat i pickimit nga mushkonjat e infektuara", thuhet në njoftimin për medie.



## Shkalla e papunësisë më 2023 ishte 10,9 %, më e ulët sesa në vitin 2022

**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) publikoi rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2023. Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 171 763) janë popullsi në moshë pune (23 663 më pak se në vitin paraprak). Persona aktivë ishin 477 350 (15 456 më pak se në vitin paraprak). Persona joaktivë ishin 694 413 (39 119 më pak se në vitin paraprak). Persona të punësuar ishin 425 499 (21 686 më shumë se në vitin paraprak). Persona të papunësuar ishin 51 851 (6 230 më pak se në vitin paraprak). Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 57,8 % (2,3 % më

e lartë sesa në vitin paraprak), kurse përqindja e femrave të punësuar ishte 24,2 % (2,2 % më e lartë sesa në vitin paraprak). Shkalla e punësimit ishte 36,3 % (2,5 % më e lartë sesa në vitin paraprak). Shkalla e papunësisë ishte 10,9 % (1,7 % më e ulët sesa në vitin paraprak). Kurse tek të rinjtë (15-24 vjeç) shkalla e papunësisë ishte 17,3 % (4,1 % më e ulët sesa në vitin paraprak). Shkalla e joaktivitetit ende vazhdon të mbetet mjaft e lartë (59,3 %), mirëpo vërehet një rënie e përqindjes (2,1 %) krahasuar me vitin paraprak. Shkalla e joaktivitetit te femrat

ishte shumë e theksuar me 75,8 % krahasuar me meshkujt (42,2 %). Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 20 %, ndërtimtaria me 11,8 %, arsimit me 9,9 %, prodhimi me 9,2 %, administrata publike dhe mbrojtja me 8,3 % etj. Femrat ishin të punësuar kryesisht në sektorët e tregtisë, arsimit dhe kujdesit shëndetësor me 54,3 % të tyre, ndërsa meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit, administratës publike dhe mbrojtjes, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimet me 62,4 %.



## Rritet për 15 për qind skema për pensionet e FSK-së



**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) publikoi Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin qershor 2024. Në muajin qershor 2024, nga pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë përfituar 847 persona ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (që ishin 735 përfitues), vërehet një rritje prej 15,2 %.

Në muajin qershor 2024, krahasuar me muajin qershor 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për

pensionet e Trepçës (-18,9 %); skema për pensionet invalidore (-17,6 %); skema e ndihmës sociale (-9 %); skema për pensionet familjare (-6,2 %); skema e pensioneve kontributpaguese të moshës (-1,3 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1 %).

Në muajin qershor 2024, krahasuar me muajin qershor 2023, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (13,8 %); Skema

për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11 %); Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (8,4 %); Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/'91 deri në vitin shkollor 1998/'99 (5,7 %); Skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,3 %); Skema e pensioneve bazike të moshës (0,9 %); Skema për veteranët e luftës (0,7 %); Skema e kompensimeve për personat e verbër (0,7 %).

## Ministria e Financave ua mbyll qasjen në sistem të pagesave zyrtarëve financiarë të komunës së Vitisë dhe të Deçanit

**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Që nga mesi i muajit korrik 2024 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka bërë mbylljen e qasjes në sistem të pagesave të zyrtarëve financiarë të komunës së Vitisë dhe të Deçanit. Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës, kjo ka ndodhur për shkak të obligimeve që burojnë nga kontratat kolektive për arsim dhe shëndetësi, dhe që për këto komuna është një shqetësim i madh dhe një shumë e papërbalueshme për



buxhetet komunale. Sipas AKK-së, vlerësohet që kjo shumë është milionëshe. "Kjo mund t'u ndodhë edhe komunave të tjera në të ardhmen. Komunat kërkojnë që qeveria ta bëjë zgjidhjen e pagesave për kontratë kolektive sepse ministratë janë nënshkruese të kontratave kolektive e jo komunat", thuhet në reagim.

Bord i Asociacionit të Komunave të Kosovës shpreh shqetësim të thellë dhe kërkon gjetjen e zgjidhjes sa më parë nga MFPT për këtë çështje,

sepse edhe po të bëhet anulimi i të gjitha projekteve të patenderuara, komunat nuk mund t'i mbulojnë as gjysmën e këtyre mjeteve. "Po ashtu, kërkojmë nga ministria përkatëse që sa më parë t'i lejojë komunat të kenë qasje në sistemin e pagesave të zyrtarëve financiarë, sepse një gjë e tillë është e padrejtë dhe ka bllokuar në tërësi punën dhe projektet që janë duke u zhvilluar, po ashtu edhe pagesat që duhet të bëhen në afat të caktuar", thuhet në fund.

## Zgjidhja për linjat e reja të autobusëve, Rama pret në takim përfaqësuesit e kompanisë ARUP

**PRISHTINË, 25 KORRIK** - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim Andrew Bamforth me delegacion nga kompania me renome botërore ARUP. Rama ka bërë

me dije se një ekip i kësaj kompanie është duke punuar për ofrimin e zgjidhjeve për linjat e reja të autobusëve dhe solucioneve të tjera të komunikacionit në kryeqytet.

"ARUP është kompani me profesionistë të nivelit botëror në fushën e inxhinierisë infrastrukturore, të trafikut e në fusha të tjera", ka shkruar Rama në "Facebook".





# Mosha, arma që u kthye në boomerang

Duke pasur në menaxhim një kandidat karizmatik, me shumë ndjekës i cili, megjithatë, fokusohet në një retorikë që sheh tërësisht nga e kaluara, nuk shkëlqen me aftësitë administrative dhe nuk i pëlqen të flasë për programe, Chris LaCivita dhe Susie Wiles, strategët e vërtetë të Donald Trump-it, e kishin ndërtuar fushatën presidenciale si një betejë të mbijetesës politike midis Trump-it dhe Biden-it, dhe jo si një sfidë të bazuar në kapacitetet e tyre qeverisëse.

Tërheqja e Biden-it nuk ishte sigurisht një rrufe në qiell të hapur, por ekipi i Trump-it, i cili e kishte menduar këtë mundësi në pranverë, duke filluar të studionte dobësitë e kandidatëve të tjerë të mundshëm demokratë, ishte i bindur se dritarja për ndryshimin e dyshes kandiduese nga partia demokratike, ishte e destinuar të përfundonte me debatin televiziv të 27 qershorit.

Tani në Mar-a-Lago ata duhet të ribëjnë nga e para një fushatë që ishte optimizuar duke luajtur me pleqërinë e një presidenti demokrat, në vështirësi të dukshme.

Në krahasim me të Trump-i, jo pa probleme, por më energjik, dukej shumë më i ri. Prandaj, siç vë në dukje edhe Anne Applebaum në The Atlantic,

pamë një konventë republikane të fokusuar tërësisht tek forca: nga performanca muskulare e Hulk Hogan deri te energjia e Kid Rock. "Lufto! Lufto! Lufto!" përsëritej deri në obsesion përballë Trumpit me grushtin e ngritur, ndërkohë që në ekranet gjigante vërshonin imazhet e reagimit të tij pas atentatit.

Ndikimi i atyre fotografive mbetet, tani është një faqe në historinë amerikane, por, pas tërheqjes së Biden-it, imazhi i Trump-it ndryshon: është më i moshuari tashmë. Një lider që mban fjalime gjithnjë e më të përsëritura, gjithnjë e më të fokusuar tek vetja. Tani që presidenti është tërhequr, është radha e Trumpit-it që të vihet në shënjestër të kritikave për gafa dhe fraza të pakuptueshme: ndonjëherë ai humbet fillin e fjalimit ose bën komente dukshëm të pakuptimta.

Ndodh prej kohësh, por deri dje në qendër të vëmendjes ishin gafat e Biden-it. Tani zhvendosen tek The Donald dhe gjithçka bën lajm: nga ngatërimi i emrave, deri tek vështirësia për të lexuar tekstin në teleprompter.

Në një vend që është ende më i freskëti dhe më dinamiku në Perëndim, me një klasë sipërmarrësish relativisht të rinj dhe moshë mesatare në



rënie të miliarderëve falë motorrit të ekonomisë dixhitale, tërheqja e atij që revista The Economist e kishte quajtur Presidenti Lear (duke iu referuar tragjedisë së mbretit të moshuar shekspirian) është shenja e mbërritjes në një pikë pa kthim, për çmontimin e gerontokracisë që ka dominuar deri tani politikën e kësaj fuqie botërore: jo vetëm Biden dhe Trump, por edhe 83-vjeçarja Pelosi, e cila ia dorëzoi udhëheqjen demokrate të Kongresit Hakeem Jeffries, një 50-vjeçar; Joe Manchin, senatori 76-vjeçar që ka mbajtur prej kohësh nën kontroll të majtën e Sanders-it,

i cili nuk kandidon më, ndërsa vetë Bernie tani është vendosur në rolin e "babait fisnik" të liberalëve. Në të djathtë, ndërkohë, kreu i senatorëve, Mitch McConnell (82 vjeç), ka dalë në fund të rreshtit.

Mbetet vetëm Trump-i. Fansat e tij, të cilët e adhurojnë, nuk i kushtojnë rëndësi moshës dhe frazave konfuzë. Por ato nuk mjaftojnë për të garantuar zgjedhjen e tij. Me Biden-in, njerëzit e tij e konsideruan të garantuar presidencën. Ata madje parashikuan një fitore dërrmuese me marrjen e mundshme të shteteve deri tani demokrate, nga Minesota

në Virxhinia.

Trump-i i lejoi "luksin" të zgjidhte një ultra të djathtë si zëvendës, në vend të një figure më të moderuar, e cila do e ndihmonte të merrte vota mes centristëve. Tani kjo zgjedhje ka filluar të duket si një gabim. Por ai e minimizon: "Harris do të jetë më e lehtë për t'u mundur se Biden-i, ajo është shumë më radikale se ai", deklaroi Trump-i dje, duke thënë se ishte i gatshëm "të merrte pjesë në më shumë se një debat" me të. / Corriere della Sera Bota.al

## Basti i madh i Emmanuel Macron-it



"Jeta politike vazhdon dhe unë nuk mendoj aspak se panem et circenses (bukë dhe cirk) mund të zgjidhë problemet. Por këto Lojëra do të sjellin një armëpushim. Do të takohemi me vendet e tjera të botës, do të gëzojmë atletët tanë, do të jetë një moment feste, uniteti", u tha dje Emmanuel Macron gazetarëve.

Presidenti i Francës vjen nga një muaj e gjysmë krize politike pa precedentë. Midis zgjedhjeve evropiane, shpërbërjes së Asamblesë Kombëtare, votimit të parakohshëm për një parlament të ri pa shumicë në një vend pa qeveri, përveç çështjeve aktuale. Por është optimist

Lojërat në zemër të Parisit janë një tjetër bast i Emmanuel Macron. Tregtarët

dhe menaxherët e restauranteve përgjatë Senës janë të zemëruar. Zona gri dhe zona e kuqe janë të mbyllura dhe pothuajse të zbrazëta, parisienët janë larguar dhe turistët nuk po vijnë.

Parisienët "vdesin" të ankohen, por arsyeja tjetër është se për herë të parë në historinë e Lojërave ceremonia e hapjes nuk do të mbahet në një stadium por mbi Senë, përgjatë gjashtë kilometrave, nga Jardin des Plantes deri tek Kulla Eifel. Me 300 mijë spektatorë, do jetë një spektakël prej gati katër orësh i përgatitur prej vitesh, që bëri të nevojshme bllokimin dhe sigurimin e një prej vendeve më të bukura në botë. Ceremonia e së premtes do të jetë momenti vendimtar për Parisin, për Lojërat dhe

për Macronin.

Nëse gjithçka shkon mirë, pa incidente, pa atentate, pa greva, pengesa ndoshta më e vështirë do të kapërcehet dhe qyteti do të mund t'i dorëzohet gëzimit të sportit dhe garave midis mbi 10 mijë atletëve nga e gjithë bota.

"Unë jam i sigurt dhe i vendosur, si gjithmonë. Ne do të festojmë vlerat olimpike përmes dymbëdhjetë tavolinave dhe do të flasim për historinë e Francës", thotë Macron. "Ne do t'i japim Francës një imazh paqeje, uniteti, diversiteti. Historia jonë do të jetë një histori respektuese ndaj ndjeshmërive të të gjithëve".

/ bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Xhudistët e Kosovës mësojnë kundërshtarët në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

PRISHTINË, 25 KORRIK - Është hedhur të enjten shorti në xhudo për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ashtu siç pritej, kampionia olimpikë, Distria

Krasniqi (-52 kg) dhe Laura Fazliu (-63 kg), janë bartëse të grupeve dhe kalojnë pa luftë raundet e para. Nora Gjakova (-57 kg) përballet në raundin e

parë me Lkhagvatogloo të Mongolisë. Akil Gjakova (-73 kg) në luftën e parë ndeshet me brazilianin Cargnin. Loriana Kuka (-78 kg) takohet

në raundin e parë me Lobnik të Sllovenisë. KOK-u i ka uruar fat dhe suksese ekipit tonë, i cili nis garat të dielën me Krasniqin.



# Krasniqi: Nëntë garuesit e Kosovës kanë potencial për medalje në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

PRISHTINË, 25 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës do të marrë pjesë me nëntë garues në Lojërat Olimpikë "Paris 2024", që nis nesër (e premte) në kryeqytetin francez. Për pjesëmarrjen e sportistëve kosovarë ka folur për Ekonomia Online, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Ismet Krasniqi. Ai ka thënë se për herë të parë Kosova po merr pjesë në olimpiadë edhe në sportin e boksit. Nga nëntë garues, pesë janë nga xhudo, një nga boksi, dy të notit dhe një prej atletikës. "Në Lojërat Olimpikë 'Paris 2024' përfaqësohet me nëntë garues nga Kosova, ku gjashtë prej tyre janë në normat olimpikë, pesë janë prej xhudos dhe një është prej boksit. Kur flasim për boksit është për herë të parë në histori që Kosova po merr edhe një normë nga një sport tjetër, sepse jemi mësuar deri më tash vetëm me xhudo. Mirëpo kemi edhe ftesa të universalitetit, që janë dy



prej notit dhe një prej atletikës. Kështu që, i gjithë ekipi është prej nëntë garuesish. Presim prej të gjithave që kanë norma olimpikë, sepse kanë potencial për medalje. Nuk mund të anashkalojmë asnjërin prej garuesve, vetëm varet edhe nga

fati sportiv në momente të caktuara. Për ta marrë normën olimpikë është një sfidë e madhe që përballet gjatë katër viteve nëpër Kampionate Evropiane Botërore. Duhet të jesh në top 10-shen botërore, kështu që është një sfidë", ka thënë

Krasniqi. Krasniqi ka pritshmëri të mëdha për sportistët kosovarë, ndërsa veçon xhudistin Distria Krasniqi. "Padyshim që pres nga xhudo, sidomos nga Distria (Krasniqi), e cila është në nivelin më të lartë të listës së bashku me

Laurën, Akilin dhe Blin Kukën, kështu që besoj se po shkojmë me pak garues, por me kualitet shumë të lartë. Ne si komitet olimpik kemi bërë punën tonë gjatë kësaj periudhe katërvjeçare duke i mbështetur sportistët tanë me bursa olimpikë me kampe stërvitore e me të gjitha punët që janë të nevojshme për të gjithë garuesit. Përgatitjet i kanë kryer në mënyrën më të mirë të mundshme. Të gjithë janë me shëndet të mirë dhe besoj që edhe me pak fat do të kemi medalje edhe në Paris", ka shtuar ai. Hapja solemne e Lojërave Olimpikë "Paris 2024" do të bëhet më 26 korrik dhe do të mbarojë më 11 gusht. Lojërat Olimpikë "Paris 2024" do të kenë 3 800 orë sport të drejtpërdrejtë dhe do të dhurohen 329 medalje ari në 32 sporte gjatë 18 ditëve të garave, të cilat do të mbahen në Paris dhe në pjesë të tjera të Francës.

## Januzaj, lojtar i ri i Las Palmasit

LAS PALMAS, 25 KORRIK - Anëtori shqiptari Adnan Januzaj do të luajë për UD Las Palmas deri në fund të sezonit, i cili bashkohet si huazim nga Sevilla. Ka qenë klubi spanjoll që ka njoftuar ardhjen e Adnan Januzajt, i cili ka nënshkruar deri më 30 qershor 2025. Januzaj e filloi karrierën profesionale në Manchester United, duke debutuar në vitin 2013. Më pas ai u huazua te Borussia Dortmundi për sezonin 2015/16 dhe te Sunderlandi për sezonin 2016/17. Në vitin 2017 Adnan Januzaj u transferua në La Liga, duke nënshkruar me Real Sociedadin, ku bëri gjithsej 132 paraqitje deri në vitin 2022. Në sezonin 2022/23 lojtari nënshkroi me



Sevilla FC, ku ka qenë deri më tani. Përveç kësaj, Januzaj debutoi me kombëtaren belge në vitin 2014, duke përfaqësuar vendin e tij në Kupat e Botës 2014 dhe 2018, ku Belgjika fitoi medaljen e bronzit.

## Karakaçi përforcon Lirinë

Prizren, 25 korrik - Skuadra e Lirisë ka njoftuar për transferimin më të ri në skuadër, i cili e përforcon repartin e mesfushës. Liria e ka bërë zyrtare transferimin e mesfushorit defensiv Abaz Karakaçi, i cili së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Elbasanit. "Karakaçi, i lindur në Shkodër dhe i dalë nga akademja e KF Vllaznia, është një lojtar me përvojë të pasur në Superligën shqiptare, duke luajtur për disa klube të njohura dhe duke u dalluar për aftësitë e tij në mbrojtje dhe zotërimin e topit. Me një lojë të fortë në mesfushë dhe mbrojtje, ai do të jetë një shtesë e vlefshme për skuadrën tonë", thuhet në njoftimin e Lirisë.



## Islami: Është nder ta bart fanellën e Prishtinës

PRISHTINË, 25 KORRIK - FC Prishtina është përforcuar me sulmuesin e krahëve, Leutrim Islami, i cili është lindur në vitin 2000 në Prishtinë. Krasniqi vjen nga shkolla e futbollit të Flamurtarit, ndërsa

ekipit prishtinas i bashkëngjitet nga KF Fushë-Kosova. "Kënaqësi dhe privilegj të jem pjesë e klubit më të madh në Kosovë. Është nder për mua që do ta bart fanellën e klubit bardhekaltër. Premtoj

se do ta jap maksimumin për klubin, për 'Plisat'. Shpresoj që së bashku t'i arrijmë synimet e ekipit", ka thënë Islami. FC Prishtina është duke u përgatitur për edicionin e ri të futbollit 2024/2025.



## Verstappeni dënohet 10 pozicione për garën e radhës në Belgjikë

**BRUKSEL, 25 KORRIK** - Pas vendit të pestë dhe faktit se ka tri gara pa fituar, një tjetër lajm i keq vjen për pilotin holandez të Red Bullit, Max Verstappen. Ai është i destinuar të kryejë një dënim me dhjetë vende në startin e garës së Çmimit të Madh të Belgjikës që zhvillohet këtë fundjavë në pistën e SPA-s.

Dënimi, që do të zyrtarizohet vetëm të shtunën, vjet për shkak të zëvendësimit të prishëm të një komponenti termik të njësisë së fuqisë së makinës së tij Red Bull. Skuadra ka zgjedhur ta kryejë këtë zëvendësim në pistën belge për një arsye të thjeshtë: i jep mundësi pilotit të parakalojë. Në fakt, kjo është

hera e katërt që Verstappeni kryen penalitetet në këtë pistë. Në vitin 2020 u penalizua 5 vende, në vitin 2022 u penalizua 10 vende dhe një vit më parë u penalizua 5 pozicione. Në dy rastet e fundit piloti holandez arriti ta fitojë garën pa shumë probleme, duke parë dominimin e Red Bullit. Skenari

është ndryshe këtë vit, pasi rivaliteti është më i madh. Tri herë kampioni i botës në Formula 1 do ta nisë të paktën nga vendi i 11-të garën (nëse siguron pole position) dhe duke parë se McLareni, Ferrari e Mercedesi këtë vit janë më në formë, do ta ketë më të vështirë ta rikuperojë dhe fitojë garën.



## Shqipëria dënohet sërish nga UEFA

**TIRANË, 25 KORRIK** - Shqipëria është dënuar sërish nga UEFA. Kombëtarja e Shqipërisë u dënuar 30 mijë euro për "racizmin e shfrytëzuar në tribuna". Skuadra e drejtuar nga Sylvinho mori një ndalim me kusht për tifozët në ndeshjen e parë jashtë fushës për shkak të sjelljes raciste të tyre në ndeshjet kundër Kroacisë dhe Spanjës. Bashkë me kombëtaren shqiptare, nga shtëpia e futbollit evropian, u gjobitën edhe gjashtë vende të tjera. Kroacia u gjobit 50 mijë euro dhe me ndalim të tifozëve për ndeshjen e parë jashtë fushës për shkak të sjelljes raciste të tifozëve në ndeshjet kundër Spanjës, Shqipërisë dhe Italisë. Po ashtu, u gjobit edhe Serbia me 30 mijë euro dhe ndalim të tifozëve për ndeshjen e parë jashtë fushës për shkak të sjelljes raciste të tifozëve në ndeshjet kundër Ukrainës, Sllovenisë dhe Danimarkës. Sllovenia u gjobit 30 mijë euro dhe ndalim me kusht për tifozët në ndeshjen e parë jashtë fushës për shkak të sjelljes raciste të tifozëve në ndeshjet kundër



Danimarkës, Anglisë dhe Portugalisë. Rumania u gjobit 40 mijë euro dhe nuk do t'i ketë tifozët në ndeshjen e parë jashtë fushës shkaku i sjelljeve raciste të tyre kundër Ukrainës, Belgjikës dhe Holandës. Hungaria u gjobit 30 mijë euro dhe ndalim me kusht për tifozët në ndeshjen e parë jashtë fushës për shkak të sjelljes raciste të tyre në ndeshjet

kundër Gjermanisë dhe Skocisë. E pa u dënuar nuk shpëtoi as Austria, që mori një gjobë prej 20 mijë eurosh, dhe nuk do t'i ketë tifozët në ndeshjen e parë jashtë fushës shkaku i sjelljeve raciste ndaj Polonisë. Kombëtarja e Shqipërisë dhe ajo e Kroacisë janë në mesin e vendeve që u dënuan më së shumti gjatë "Euro 2024" për shkak të sjelljeve të tifozëve.

### SHKURT

#### Daku, pjesë e formacionit të javës në Rusi

Mirlind Daku ka arritur ta kalojë si është më së miri periudhën e keqe që e pati pas përfundimit të Evropianit për Kombëtaren e Shqipërisë. Daku ishte kryetëm në Kampionatin Evropian. Ai ishte dënuar nga UEFA me dy ndeshje moslojë për shkak se pas ndeshjes me Kroacinë mori altoparlantin dhe nisi një këngë fyese ndaj serbëve dhe maqedonasve. Më pas, klubi në të cilin ai bën pjesë, Rubin Kazani, kishte hapur ndaj tij një procedurë disiplinore. Por, të gjitha këto Mirlindi i ka lënë pas krahëve dhe ka filluar shkëlqimin me Rubinin. Daku ishte njeriu i ndeshjes së javës së parë mes Nizhny Novgorodit dhe Rubin Kazanit, ku skuadra e tij fitoi me rezultat 4-2. 26-vjeçari ishte autor i një goli dhe një asistimi, duke qenë rreziku kryesor në portën e vendasve. Pas çmimit lojtari i ndeshjes, sulmuesi kuqezi është futur në formacionin më të mirë të javës së parë në Ligën Premierë të Rusisë. Ai është sulmuesi kryesor në 11-shën më të mirë të javës, duke dëshmuar se është në një formë të shkëlqyer.

#### Ofertë me rrogë të majme nga Katari për Gjimshitin

Karriera e Berat Gjimshitit mund të vazhdojë në Katar. Mbrojtësi shqiptar i Atalantës është kërkuar nga Al-Rayyan dhe tashmë janë duke u zhvilluar disa kontakte mes palëve. Pas gjashtë sezoneve radhazi tek Atalanta dhe nëntë sezoneve në Itali, Gjimshiti mund t'i thotë lamtumirë Serisë A dhe të transferohet në Katar. Në fakt, janë duke u zhvilluar disa kontakte që mbrojtësi i lindur në vitin 1993 të kalojë tek Al-Rayyan. Ai ende nuk ka dhënë "ok" final për të bërë këtë kalim, por oferta sa i përket kontratës dhe rrogës duket të jetë e majme. Vlerësimi i kartonit nga Atalanta shkon në 10 milionë euro. Priten zhvillime të tjera. Kjo lëvizje e mundshme përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm për Gjimshitin, i cili pjesën më të madhe të karrierës profesionale e ka kaluar në Itali. Atalanta, e njohur për marrëveshjet e saj të mprehta të transferimeve, ka të ngjarë të kërkojë të sigurojë një marrëveshje të favorshme nëse vendos t'i ndajë rrugët me mbrojtësin me përvojë. Për Gjimshitin, një lëvizje në Katar mund të ofrojë një sfidë të re dhe kushte potencialisht fitimprurëse financiare, ndërsa ai hyn në fazat e fundit të karrierës së tij.

#### Pogba: Futbolli ka qenë pjesë e jetës sime

"Të gjitha rrugët çojnë tek apeli: deri në atë moment, objektivi im do të jetë të jem në formë dhe të pres". Paul Pogba është kthyer të flasë për shkualifikimin prej katër vitësh për doping. "Futbolli ka qenë pjesë e jetës sime gjithmonë", ka thënë mesfushori francez në një intervistë të dhënë për "Forbes". "Megjithatë, kam familjen time, besimin tim, miqtë e mi dhe fansat e mi që më mbështesin, gjë që i bën gjërat më të lehta: gjithçka do të shkojë mirë".

## Shitja e biletave problem, Olimpiada rrezikon të zhvillohet në stadione të boshatisura

**PARIS, 25 KORRIK** - Rreziku i tribunave bosh në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" mund të kthehet në një problem për organizatorët. Kjo është ajo që del nga një hulumtim i "Financial Times", sipas të cilit, numri i biletave të disponueshme për rishitje në faqet zyrtare të internetit po rritet ndjeshëm. Në thelb, shumë entuziastë kanë blerë bileta për disa gara apo ceremoni të cilat nuk do të marrin pjesë, me rrezikun që sportistët të garojnë në një stadium bosh. Numri i rishitjes së biletave u rrit në 271 637 të martën nga rreth 180 000 një muaj më parë. Ofertat më të shtrenjta në faqen e rishitjes janë për ceremoninë e hapjes, me vendet më të mira në 2 970 euro. "Financial Times" kujton se tifozët që dëshironin të mermin pjesë në gara u detyruan të blinin blloqe biletash



për tri ngjarje të veçanta gjatë fazës së parë të shitjeve. Megjithatë, organizatorët thanë se çdo biletë e padëshiruar mund të rishitet përmes kanalit zyrtar. Biletat duhet të rishiten me vlerën nominale, por blerësit duhet të paguajnë një tarifë rezervimi shtesë prej 10 %, ndërsa

shitësit goditen me një komision prej 5 %. Sipas disa përdoruesve, ka aq shumë bileta atletike në shitje sa që vështirë se do të mund t'i vendosin të tyret. Organizatorët thanë se rreth 250 000 bileta u shkëmbyen përmes vendit të rishitjes.

## Napoli në bisedime me Chelsea për Lukakun

Napoli është në kontakt me Chelsea përsëri për të diskutuar për opsionet e mundshme rreth ish-sulmuesit të Romës dhe Interit, Romelu Lukaku, i cili ra dakord për kushtet personale me napolitanët javën e kaluar. Sipas

raporteve nga Gianluca Di Marzio, Napoli dhe Chelsea rikthyen bisedimet për Lukakun të mërkurën, ndërsa të dyja palët përpiquan të bien dakord për një çmim të arsyeshëm shitjeje. Chelsea raportohet se është e

gatshme t'i ulë kërkesat e tyre nga çmimi fillestar prej 44 milionë eurosh, në rreth 35 milionë euro. Ndërkohë, Napoli vazhdon të shtyjë për një çmim më të afërt me 25 milionë euro për Lukakun, i cili ka dy vjet të mbetura në

kontratën e tij të leverdishme në Londrën Perëndimore. 31-vjeçari është i gatshëm të bëjë një sakrificë të madhe në pagën e tij aktuale, pasi raportet e javës së kaluar detajojnë se ai ka rënë dakord për një kontratë prej 6

milionë eurosh në sezon, përjashtuar bonuset, në kryeqytetin italian. Golashënuesi më i mirë i Belgjikës shihet si zëvendësues i Victor Osimhen, i cili, me gjasë, do t'i bashkohet PSG-së.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 25.07.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

## Shpallje Publike T-24-12

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.  
Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000  
Personi Kontaktues: Behxhet Nimani  
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com  
Telefoni: +381 28 538 050  
Faks: +381 28 539 202

### Shpallja Publike

#### Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e objektit të Njësia Biznesore Industria Kimike
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

#### 1. Njësia Biznesore Industria Kimike

##### 1. Çmimi fillestar

25.07.2024 Njësia Biznesore Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Depoja e pjesëve rezervë	750.00	1.150	0.207	1.357	1,017.75

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë  
Data e shpalljes: 26.07.2024  
Sqarimi: deri me 13.08.2024  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 13.08.2024  
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)  
Afati i fundit i dorëzimit: 13.08.2024 në 11:00  
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

#### Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

#### Shënime shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneks 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

#### Aneksi 1

#### OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e qerasë për sipërfaqen e mbuluar	
a	Sipërfaqe e mbuluar m2

Llogaritja e qerasë për sipërfaqen e mbuluar	
a	Sipërfaqe e mbuluar m2
b	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) pa TVSH
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m2 në (€)
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) me TVSH
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)
e=c+d	Për pagesë në (€)

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

#### Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 13.08.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyrën e Shitjes.

#### Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve.

Objekti është i ndarë në lote,

**Trepça Sh.A.** përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termat dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

#### DHËNIE ME QIRA E OBJEKTIT

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe llogaritja përfundimtare në faturim

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 2MW në Prilep, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.09.2024 në ora 11:00 në objektin e komunës se Deçanit, do të organizohet debat publik nga Kompania "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

[https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLnnpvb20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzlGM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjQ1Y2I1MTQyMmIwZTM3YjNiOGQ4Y2Ix&t=YkZxNVAXTIRhRzFCQUFJSmlwS1pwUTZoOUZFUmcxQzFSeVM2T3RacG1FUT0=&h=c3734878f20b49f0bc85b8c9956136b4&s=AVNPUehUT0NFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55\\_29at16bUHiQ](https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLnnpvb20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzlGM2U4UUUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjQ1Y2I1MTQyMmIwZTM3YjNiOGQ4Y2Ix&t=YkZxNVAXTIRhRzFCQUFJSmlwS1pwUTZoOUZFUmcxQzFSeVM2T3RacG1FUT0=&h=c3734878f20b49f0bc85b8c9956136b4&s=AVNPUehUT0NFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ)

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "AQ Tolaj" Sh.p.k Deçan për impiantin fotovoltaiik 2MW në Prilep, Deçan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kleopatra Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën për parukeri të lëshuar nga QAP—Gjakovë.

- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollë së mesme "Arkitekt Sinani".

- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale "Bahri Haxha"-ish shkolla e mesme "Muharrem Bekteshi".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



# TRADITË QË NGA

# 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

